



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	13.01.2026.
01 NR/BR.	07/26

PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete z. Jeton Emini.

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika e. lidhur me nenin 61 paragrafi 3 të Ligjit, Nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.4, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2023, për Procedurat e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete z. Jeton Emini.

A r s y e t i m

Duke i mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2023, për Procedurat e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna. Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

Edhe në rast kur përqindja është më e vogël se 10% emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë, mund të bëhet pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës.

Andaj propozoj që ky propozim vendim si e tillë të miratohet.